- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Për plotësimin e treguesve ekonomiko-financiar të Programit të Zhvillimit të miratuar për vitin 2026, si dhe emergjencat e qendrës, është e domosdoshme të sigurohen materialet:

“Lëndë e Parë për Fonderinë” që përdoren në :

1.Gize verxhino:

Element i domosdoshëm për përmirësimin strukturor dhe realizimin e markës së duhur në derdhjet e çelikut dhe gizes, në prodhimin e detaleve me rekupero gize.

2.Bronx bllok (lingotë):

Element kryesor për realizimin e derdhjeve të detaleve prej bronxi.

3.Qymyr koks

Element i domosdoshmëm për realizimin e shkrirjes së metaleve me ngjyra.

4.Dru zjarri përdoren në proceset teknologjike për ngrohjen e detaleve të cilat çiftëzohen ndërmjet tyre, si dhe për djegjen e nyjeve të mëdha për pastrimin e tyre nga vjarat, serrat dhe mbeturina të ndryshme.

5.Kallaj përdoret për lidhjet bakër-kallaj në sektorin e fonderisë.

6.Vaj lini

Element përzierës për përgatitjen e dheut formues të zemrave në repartin e fonderisë.

Baza materiale si më sipër do të përdoret menjëherë në proceset e punës e të prodhimit në qendrën tonë.

SPECIFIKIMET TEKNIKE**“Gizë verxhino”**

1. EMËRTIMI : Gizë verxhino e markës G-20, në formë blloku (lingotë)

2. KËRKESAT TEKNIKE

- Përbërja kimike:

Marka	Përmbajtja në % e elementëve :			Përmbajtja ne % e elementëve: jo më shumë se:		
	C	Si	Mn	P	S	Cr
G-20	0.20	1.75-2.25	0.5-0.9	0.1	0.05	0.1

3. PËRDORIMI :

Në repartin e Fonderisë, si element për përmirësimin strukturor dhe realizimin e markës së duhur në derdhjet e çelikut dhe gizës, në prodhimin e detaleve me rekupero gize.

4. ORIGJINA E MALLIT :

Prodhim importi nga firma të mirënjohura.

5. MARKETIMI :

Në çdo koli gize duhet të jetë ngjitur një etiketë metalike ku të jenë vendosur :

- Origjina (prodhuesi dhe shteti i origjinës)
- Marka e gizës verxhino G-20
- Pesha neto dhe bruto
- Përbërja kimike e gizës verxhino G-20

Giza verxhino G-20 duhet të jetë e shoqëruar me këto dokumenta:

- Çertifikatë e origjinës së mallit
- Çertifikatë e kontrollit të cilësisë së mallit

6. AMBALLAZHIMI:

Giza verxhino G-20 bllok (lingotë) duhet të jetë e përgatitur në formë pllake lingote, me një kanal në mes, për thyerjen në mes të saj.

Lingota në formë pllakë duhet të peshoje 10÷15 kg.

Në lingotën bllok duhet të jetë e shënuar me ngjeshje marka e gizës verxhino G-20.

SPECIFIKIMET TEKNIKE**“Bronx bllok (lingotë)”**

1. EMËRTIMI :

- Bronx bllok (lingotë)

2. MARKA : BrSnPbZn 5-5-5

3. KERKESAT TEKNIKE :

- Pesha specifike në gjendje të ngurtë: 8.8 Gr/cm³
 - Kufiri i soliditetit në tërheqje: $\sigma_{qt} = 15 \div 18 \text{ KG/mm}^2$
 - Fortësia në sipërfaqe: 290 ÷ 320 HB
- Përbërja kimike :
- a. Përbërësit kryesore
- Sn = 4 ÷ 6%
 - Pb = 4 ÷ 6%
 - Zn = 4 ÷ 6%
 - Cu = 87 ÷ 81%
- b. Elementë shtesë
- Al ≤ 0.06 %
 - Sb ≤ 0.05 %
 - Shuma e elementëve të tjerë ≤ 1.3%

4. PËRDORIMI :

Në repartin e fonderisë për derdhjen e detaleve prej bronxi.

5. AMBALLAZHIMI :

- Të jenë në formë pllake lingote, me një vijë- kanal në mes për thyerjen e saj.
- Lingota në formë pllakë të peshojë 10 ÷ 15 kg.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Qymyr Koks”

EMËRTIMI : Qymyr koks

2. KËRKESAT TEKNIKE:

Qymyri koks duhet të ketë përberjen kimike të mëposhtme :

- C ≥ 86% ;
- S ≤ 1.0% ;
- Substanca relative ≤ 1.5% ;
- Lagështia ≤ 5%
- Hiri ≤ 1% .
- Fuqia kalorifike e qymyrit duhet të jetë mbi 7000 KiloKal./kg.
- Temperatura e ndezjes 650 ÷ 750°C.
- Karakteristika e thërmimit të koksit mbi 80%.
- Poroziteti jo më shumë se 40%.
- Përmasat e kokrrave të qymyrit të jenë jo më të vogla se 40 mm.
- Nën përmasën 40mm nuk duhet të jenë me shumë se 5% e kokrrave të qymyrit.

- Kërkesat teknike sa më sipër do të verifikohen në procesin e shkrirjes së metaleve me ngjyra.

PËRDORIMI

Në Repartin e Fonderisë për shkrirjen e metaleve me ngjyra.

3. ORIGJINA E MALLIT :

Të jetë prodhim vendi ose i huaj .

4. AMBALLAZHIMI :

Qymyri koks duhet të jetë i ambalazhuar në thasë me peshë deri 25÷50 kg ose në arke druri me peshë 50÷100 kg .

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Dru zjarri”

1. EMËRTIMI : “Dru zjarri”

2. KËRKESAT TEKNIKE:

Drutë e zjarrit duhet të jenë dru prej mare, shkoze, dhe shqok.

- Lagështia ≤ 10÷15 %
- Gjatësia e druve 1÷1.2 ml
- Diametri i druve 50÷80mm

PËRDORIMI

Dru zjarri përdoren në proceset teknologjike për ngrohjen e detaleve, të cilat çiftëzohen ndërmjet tyre, si dhe për djegien e nyjeve të mëdha për pastrimin e tyre nga vjarat, serat dhe mbeturina të ndryshme.

ORIGJINA E MALLIT :

Të jetë prodhim vendi.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Kallaj bllok (lingotë) me simbol kimik Sn”

1. EMËRTIMI : Kallaj bllok (lingotë) me simbol kimik Sn
Për përdorim në sektorin e Fonderisë, për lidhjet bakër-kallaj.

2. KËRKESAT TEKNIKE:

Marka	Përbërësi kryesor	Përmbajtja në % e elementëve jo më shumë se:
-------	-------------------	--

	Sn >	As	Fe	Cu	Pb	Bi	Sb	S	Gjithë përbërësit
Sn 1	99.56	0.02	0.02	0.03	0.25	0.05	0.05	0.02	0.44
Sn 2	98.39	0.10	0.5	0.010	1.00	0.06	0.30	0.04	1.65
Sn 3	96.25	0.10	0.5	0.015	3.00	0.10	0.30	0.06	3.75

- Peshë specifike në gjendje të ngurtë.....7.3Gr/cm³.
- Temperatura e shkrirjes.....231.9°C.
- Kufiri i solidaritetit në tërheqje.....6qt=2.7Kg/mm²
- Fortesa në sipërfaqe.....5HB
- Kallaji duhet të ketë ngjyrë të bardhë ose të hirtë.

3. ORIGJINA E MALLIT :

Prodhim importi.

4. AMBALLAZHIMI :

Kallaj bllok (lingotë) duhet të jetë i përgatitur në formë pllake lingote, me një vijë kanal në mes për thyerjen e saj.

Lingota në formë pllake duhet të peshojë 3÷5 kg.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Vaj lini”

1. EMËRTIMI : Vaji lini .

2. KËRKESAT TEKNIKE :

- Peshë specifike në 20°C 0.927÷0.936 gr/cm³
- Precipitati ≤0.10 %
- Numri jodik ≥170
- Soliditeti ndaj këputjes në të thatë ≥10.50 kg/cm²

3. PËRDORIMI :

Element përzjerës për përgatitjen e dheut formues të zemrave në repartin e Fonderisë.

4. ORIGJINA E MALLIT :

Prodhim vendi ose importi.

5. AMBALLAZHIMI :

Në bidona plastik deri 50 litra.

Për plotësimin e treguesve ekonomik-financiar të Programit të Zhvillimit të miratuar për vitin 2026, është e domosdoshme të sigurohen materialet specifike për qendrën tonë :

1. Vaj naftalik

Përdoret si lëng ftohës dhe lubrifikues, i tretur me ujë, i domosdoshëm gjatë proceseve të punës në të gjitha makinat metal prerëse dhe retifikuese.

2. Vajguri TS1
Shërben si material kryesor në procesin e ngopjes me karbon të sipërfaqeve të detaleve, në furrat e çimentimit në repartin e trajtimeve termike dhe si lubrifikues e ftohës në makineritë e Ilustrimit të detaleve.
3. Shufra bronxi për saldime me gaz & oksigjen me diametër Ø3 mm, gjatësi 1000 mm
Përdoren bashkë me elementët ndihmës oksigjen&acetilen në saldime dhe si materiale mbushëse për ngjitjen e vidiove në thikat e makinerive metal prerëse .
4. Shirrita sharre bimetalik për prerje çeliku tip : 3660x27x0.9 mm, 4/6 TP1-K
Është instrument prerës në makinat sharra mekanike, dhe që shërben për prerjen e prokateve prej çeliku me diametra e marka të ndryshme.
5. Lampa ndriçimi për torno 36v; 60ë
Element përbërës i domosdoshëm në makineritë metal prerëse , për të realizuar ndriçimim lokal të detalit gjatë punimit të tij në këtë makineri, janë specifike si pasojë e tensionit të punës .
6. Mandrino vetçentruese Ø 315mm
Pajisje e domosdoshme për kapjen e detaleve në makinat metal prerëse tip Torno, gjatë punimeve mekanike të heqjes së ashkles.
7. Anhidrid Kromi
Përdoret si element kryesor në procesin e elektrolizës për kromimin e detaleve në repartin e galvanizimit.
8. Maja diamanti industrial K=3 mm
Përdoret për retifikimin e gurëve abraziv në retifikat universale dhe ato pa qendër.
9. Acid sulfurik
Përdoret për përgatitjen e tretësirës në vaskat e kromimit të detaleve.

Baza materiale si më sipër do të përdoret menjëherë në proceset e punës e të prodhimit në qendrën tonë.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Vaj naftalik”

1. EMËRTIMI : Vaj naftalik (sapun naftalik) tip “EMULSOL IBH-1
2. KËRKESAT TEKNIKE :

• Pamja e ftohësit	Vaj i lëngshëm
• Densiteti ne temperaturë 20°C	0.90÷0.97 gr./cm ³
• Vizkoziteti kinematik në temperaturën 40°C	≥70 mm ² /S
• Temperatura e flakërimit në ambient të hapur	≥145°C
• Numri i neutralizimit	17÷21 mgKOH/g
• Numri i sapunizimit	≥30 mgKOH/g
• Përmbajtja e ujit ne vajin naftalik(sapunin naftalik)	≤1%
• Ruajtja e stabilitetit në temperatura të ulëta	Stabël(i qëndrueshem)
• Shpejtësia e vajt naftalik(sapunit naftalik) “S”	≤600
3. PËRDORIMI :

Lëngu ftohës(vaj naftalik ose sapuni naftalik) tip “EMULSOL IBH-1”:

- i destinuar për ftohje në makinat metalpunuese me heqje ashkle në prodhimin e detaleve ferroz e jo ferroz ne repartin Mekanik .
- përpara përdorimit në makinat metalpunuese duhet të tretet me uje në raport në peshë 1 me 5.

4. AMBALLAZHIMI :

- Vaji naftalik (sapun naftalik) të jetë i amballazhuar në bidona plastik 5÷20 litra.

5. GARANCIA E CILËSISË :

- Të ketë qënë ruajtur në dhoma të mbyllura në temperaturë $+(10\div 20)^{\circ}\text{C}$.
- Afati i përdorimit 12 muaj që nga data e prodhimit.

6. PRANIMI I MALLIT :

Çdo bidon plastik me vaj naftalik(sapun naftalik) të ketë të ngjitur një etiketë letre me këto të dhëna :

- Origjina (Prodhuesi dhe shteti i origjinës).
- Marketimi dhe specifikimet teknike.
- Pesha neto dhe bruto.
- Data dhe viti i prodhimit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Vajguri i markes TS-1”

1. EMËRTIMI : “Vajguri i markës TS-1”

2. KËRKESAT TEKNIKE :

- | | |
|---|--------------------------------|
| • Pamja | I tejdokshëm pa ngjyrë |
| • Densiteti në temperaturën 20°C | 0.775 gr /cm^3 |
| • Vizkoziteti kinematik në temperaturën 2°C | $\geq 1.4 \text{ m /S}$ |
| • Temperatura e flakërimit në ambjent te mbyllur | $\geq 28^{\circ}\text{C}$ |
| • Përmbajtja e squfurit | $\leq 0.2\%$ |
| • Fuqia kalorifike | $\geq 1010 \text{ Kkalori/kg}$ |
| • Temperatura e fillimit të vlimit | $\leq 150^{\circ}\text{C}$. |
| • Uji dhe mbeturinat mekanike | $=0\%$ |

3. PËRDORIMI :

Shërben si material kryesor në procesin e ngopjes me karbon të sipërfaqeve të detaleve, në furrat e çimentimit në repartin e trajtimeve termike dhe si lubrifikues e ftohës në makineritë e Ilustrimit të detaleve.

4. ORIGJINA E MALLIT :

Preferohen mall importi.

5. AMBALLAZHIMI :

I amballazhuar në fuçi 200 litra dhe të jetë e shoqëruar me karakteristikat teknike te vajgurit.

6. PRANIMI I MALLIT :

Kapaku i fuqisë të ketë vulën e sigurisë të fabrikës prodhuese.

SPECIFIKIMET TEKNIKE
“Shufër bronxi për saldim me gaz & oksigjen”

1. EMËRTIMI : “Shufër bronxi për saldim me gaz & oksigjen”

2. PËRMASAT :

Me përmasa Ø 3x1000mm

3. KËRKESAT TEKNIKE :

- Marka : BrPbZnSn 5-5-5
- Përbërja kimike :
 - Cu =80÷85%;
 - Pb= 4÷5%;
 - Zn= 4÷5%
- Sn=4÷5%.
- Vetitë fiziko-mekanike:
- Zgjatimi relative: $\delta \leq 4\%$.
- Përkulshmëria : $\sigma = 90 \div 100\text{kg/cm}^2$

4. PËRDORIMI :

Përdoren bashkë me elementët ndihmës oksigjen&acetilen në saldimet dhe si materiale mbushëse për ngjitjen e vidiove në thikat e makinerive metal prerëse .

5. ORIGJINA E MALLIT :

Prodhim vendi ose importi .

6. AMBALLAZHIMI :

Në qese plastike.

SPECIFIKIMET TEKNIKE
“Shirit sharrë bimetalik”

1. EMËRTIMI :

Shirit sharre bimetalik për prerjen e prokateve prej çeliku me legim të lartë elementësh special si : Cr , Mn , V , E , Ni etj.

2. KËRKESAT TEKNIKE :

- Dimensionet: 3660x27x0.9mm.
- Gjatësia 3100mm
- Hapi i dhëmbëve: $\frac{3}{4}$.
- Tipi : TP1- K .

-
- Të jetë i çertifikuar sipas ISO 9001.
3. PËRDORIMI :
Është instrument prerës në makinat sharra mekanike, dhe që shërben për prerjen e prokateve prej çeliku me diametra e marka të ndryshme.
 4. ORIGJINA E MALLIT :
Prodhim vendi ose importi .
 5. AMBALLAZHIMI :
Tehu prerës duhet të jete i izoluar me material plastik.
Shiriti sharrës bimetalik të jetë vendosur në një kuti kartoni, ku të jetë vendosur një etiketë që të tregojë dimensionet e saj.
 6. PRANIMI I MALLIT :
Shiriti sharrës bimetalik duhet ti nënshtrohet kontrollit të specifikimeve teknike dhe testit praktik.

SPECIFIKIMET TEKNIKE
“Llampa ndriçimi për torno 36v, 60w”

1. EMËRTIMI : Llampa ndriçimi per torno 36v; 60ë
2. TIPI: Llampa që punojnë në tensione të ulëta
3. KËRKESAT TEKNIKE :
 - Llambat të jenë inkadeshente
 - Tensioni i punës $V = 36$ volt
 - Fuqia e llampës 60 ëat
 - Xokoli i llampës normal
 - Materiali ngjitës i xokolit me llampën, të duroj temperaturë mbi > 70 °C
4. PËRDORIMI :
Element përbërës i domosdoshëm në makineritë metal prerëse , për të realizuar ndriçimim lokal të detalit gjatë punimit të tij në këtë makineri, janë specifike si pasojë e tensionit të punës .
5. ORIGJINA E MALLIT:
Prodhim importi
6. AMBALLAZHIMI:
Në kuti prej kartoni ku të jetë e shënuar tensioni i punës dhe fuqia

SPECIFIKIMET TEKNIKE
“Mandrino vetëcentruese”

1. EMËRTIMI : Mandrino vetëcentruese Ø 315mm

2. TIPI: Me nofulla vetëcentruese

3. KËRKESAT TEKNIKE :

Dimensionet e mandrinos :

- djametri i jashtëm : Øj = 315 mm
- gjerësia : B = 90 mm

Diapazoni i punimeve të detaleve me mandrino:

- Nga jashtë dhe brenda: Ø = 0 ÷ 315 mm

Nofullat e mandrinos të jenë:

- numri i nofullave: 3 (tre)
- vetëcentruese kur kapet detali
- dy palë nofulla : një palë për punime të brendshme dhe një për punime të jashtme.
- më të njëjtin çelës për lirim dhe shtrëngim detali.

Preçizioni i mandrinos pas kapjes detailit:

- hedhjet radiale 0 ÷ 0.03 mm
- hedhjet ballore 0 ÷ 0.03 mm

4. PËRDORIMI :

Pajisje e domosdoshme për kapjen e detaleve në makinat metal prerëse tip Torno, gjatë punimeve mekanike të heqjes së ashkles.

5. ORIGJINA E MALLIT:

Prodhim importi

6. AMBALLAZHIMI:

Në kuti prej dërrase dhe e grasatuar.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Anhidrit kromi CrO₃”

1. EMËRTIMI : Anhidrit kromi CrO₃ ose (Chromic Acid).

2. KERKESAT TEKNIKE :

- Përbërja kimike:
 - Trioksid Kromi, CrO₃ 99.7 min. %
 - Sulfate , SO₄ 0.08 max. %
 - Klorure , Cl 0.01max. %
 - Hekur , Fe 0.01max. %
 - pH (at koncentrim prej 10 g/l ne 20°C) 3.6-4.4

3. KARAKTERISTIKAT KIMIKE DHE FIZIKE

- Pamja(dukja) Homogjene, theksohet në të kuqe të

errët, në formë petëza.

- Pesha molekulare 99.99 gr/gmol
- Densiteti Bulk 1.4 gr/cm³
- Pesha specifike 2.7 gr/cm³
- Pika e shkrirjes 197 °C
- Shuma e materialeve të lidhura 0.01max %
- Tretshmëria në ujë në 20°C 62 %

4. PËRDORIMI :

Përdoret si element kryesor në procesin e elektrolizës për kromimin e detaleve në repartin e galvanizimit.

5. ORIGJINA E MALLIT

Prodhim importi .

6. AMBALLAZHIMI :

Në fuçi metalike me peshë 25-50 kg, të mbyllura hermetikisht. Të magazinohet ne vende të ftohta e të thata . Të mbahet larg nga rrezet e diellit e ngrohjet.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Acid Sulfurik”

1. EMËRTIMI : Acid Sulfurik H₂SO₄

2. KARAKTERISTIKAT KIMIKE DHE FIZIKE

- Pamja(dukja) Pa ngjyrë, lëng vajor, tymon në ajë me lagështi
- Përqëndrimi 98 %
- Densiteti 1.84 gr/cm³
- Pesha specifike 1.91 gr/cm³
- Pesha molekulare 98.072 gr/gmol
- Pika e shkrirjes 10 °C
- Pika e vlimit 337 °C

3. PËRDORIMI :

Përdoret si element kryesor për kromimin e detaleve në repartin e galvanizimit dhe në kryerjen e analizave në laboratorin kimik.

4. ORIGJINA E MALLIT

Prodhim importi .

5. AMBALLAZHIMI :

Në shishe qelqi me peshë 1-5 l të mbyllura hermetikisht . Të magazinohet ne vende të ftohta e të thata . Të mbahet larg nga rrezet e diellit e ngrohjet.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Maja diamanti industrial K=3 mm”

EMËRTIMI: “Maja diamanti industrial K=3 mm”.

2. KERKESAT TEKNIKE :

- Përbërja kimike:
 - Kokrrizë diamanti industrial
 - Numri i kokrrizës K=3mm”
 - Trupi që mban kokrrizën ka dimensione
- Diametri i madh = 12 mm
- Diametri I vogël = 10mm
- Gjatësia = 60mm

3. PËRDORIMI :

Përdoret për mprehjen e gurëve abraziv në makinat metalprehëse retifika.

4. ORIGJINA E MALLIT

Prodhim importi .

5. AMBALLAZHIMI :

Në qese plastike.

Për plotësimin e kërkesave të qendrave të prodhimit e shërbimit për prodhime të pjesëve të gomuara, është e domosdoshme të sigurohen materialet:

1. Brum gome antivaj

Përdoret për prodhimin e detaleve prej gome dhe gomë-metal, të cilat punojnë në ambiente me praninë e vajit dhe grasos.

2. Kauçuk sintetik

Përdoret si element përzjerës me gomën, për riaktivizimin dhe rritjen e elasticitetit të saj.

Baza materiale si më sipër, do të përdoret menjëherë për të prodhuar guarnicione permistopi gryke pusi, gomina hermetizuese kapaku valvule, gomina kapake këmishe, permistopa stele ,gomina pakerash hidromekanik dhe mekanik ,gomina hermetizuese valvula sigurimi për pompat e transportit të naftës ,me qëllim plotësimin e kërkesave vjetore për vitin 2026 të qendrave.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Brumë gome antivaj”:

1. EMËRTIMI:

- Brumë gome antivaj

2. PËRDORIMI :

Për prodhimin e detaleve prej gome dhe gomë-metal.

3. KARAKTERISTIKAT TEKNIKE :

- Vullkanizimi 30 min për temperaturën +143⁰ C.
- Qëndrueshmëria në tërheqje $\geq 75\text{kg/cm}^2$.
- Zgjatim relativ $\geq 220\%$
- Fortësia sipas SHOR-it 80^{±5}
- Qëndrueshmëria në fortësi në temperaturën deri - 48⁰ C
- Koeficienti i vjetërimit ≥ 0.8 muaj, në temperaturën + 25÷40⁰ C.
- Deformimi mbetës $\leq 8\%$.
- Karakteristikat sa më sipër të brumit të gomës, do të vërtetohen :
 - Gjatë përpunimit në kalandër si dhe pjekjes së tij në presforma gjatë prodhimit të detaleve.
 - Pas mbajtjes në ambient vaji për 5 min, nuk duhet të shfaqë dekarbonizim në sipërfaqe.

4. ORIGJINA E MALLIT:

Prodhim vendi ose importi, i certifikuar nga ISO 9001-2000.

5. AMBALLAZHIMI:

Të jetë në formë tabaku, me peshë 10÷15kg dhe gjithë sipërfaqja e brumit të gomës duhet të jetë e plastifikuar me polietilen.

6. MARKETIMI:

Në çdo tabak brumi i gomës antivaj duhet të jetë ngjitur një etiketë letre ku të jenë të vendosur:

- Data e prodhimit dhe data e skadencës
- Pesha neto dhe bruto

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Kauçuk sintetik”

1. EMËRTIMI:

- Kauçuk sintetik

2. PËRDORIMI :

Si element përzjerës me gomën për riaktivizimin dhe rritjen e elasticitetit të saj.

3. KARAKTERISTIKAT TEKNIKE :

- Përbërja kimike :
- Cis-polyisprene
- C-H
- Pesha molekulare 1000÷1 milion dalton
- Përbërësit kryesorë: polimerët elastik
- Vetitë mekanike :
- Struktura molekulare e materialit të jetë e tillë që pas zgjatimit të tij, të kthehet në gjendje fillestare.
- Temperatura e shkrirjes +180⁰ C (356F).

4. ORIGJINA E MALLIT:

Prodhim importi ose vendi, i certifikuar nga ISO 9001-2000.

5. AMBALLAZHIMI:

Të jetë në formë tabaku, me peshë 10÷15kg dhe gjithë sipërfaqja e tij të jetë e plastifikuar me polietilen.

6. MARKETIMI:

Në çdo tabak kauçuku, duhet të jetë ngjitur një etikete letre ku të jenë të vendosur:

- Data e prodhimit dhe data e skadencës
- Pesha neto dhe bruto

Për plotësimin e treguesve ekonomiko- financiar të Programit të Zhvillimit të miratuar për vitin 2026, të detajuar sipas tremujorëve është e domosdoshme të sigurohen materialet:

3. Sfera Inoksi me dimensione të ndryshme

Përdoren në repartin mekanik për përgatitjen e valvolave dhe pjesëve të këmbimit të pompave të thellësisë 2” ; 2 ; 1/2 dhe 3.

Baza materiale si më sipër, do të përdoret menjëherë në proceset e punës për prodhimin e pompave të thellësisë dhe pjesëve të këmbimit për to.

SPECIFIKIME TEKNIKE**“Sfera Inoksi”****7. EMËRTIMI:**

- Sfera thithje pompa thellësie Ø 3

8. DIMENSIONI : Diametri Ø 1^{1/2} (Ø38.20 mm)**9. MARKA : Çelik 9 Cr18****10. KARAKTERISTIKAT TEKNIKE :**

- Pastërtia e sipërfaqes së lapuar 0.8 (ashpërsia)
- Fusha e tolerancës së prodhimit ±0.20mm
- Marka e materialit 9Cr 18
- Në sipërfaqe të mos ketë vijëzime të cilat dallohen me lupë 1x10.
- Fortësia e sipërfaqes 55÷62HRC

11. AMBALLAZHIMI:

Të jetë të paketuara në kuti kartoni jo më shumë se 50 copë / kuti.

Nëpër kuti sferat të jenë të lyera me vaj për mbrojtje nga oksigjeni dhe të mbështjella me plasmas.

Kutitë të jenë të pajisura me etiketa që shprehin dimensione, markën dhe sasitë

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Sfera Inoksi”:

1. EMËRTIMI:

- Sfera thithje pompa thellësie Ø 2^{1/2} dhe shtytje pompa thellësie Ø 3

2. DIMENSIONI : Diametri Ø 1^{1/4} (Ø 31.75mm)

3. MARKA : Çelik 9 Cr 18

4. KARAKTERISTIKAT TEKNIKE :

- Pastërtia e sipërfaqes së lapuar 0.8 (ashpërsia)
- Fusha e tolerancës së prodhimit ±0.18mm
- Marka e materialit 9 Cr 18
- Në sipërfaqe të mos ketë vijëzime të cilat dallohen me lupë 1x10
- Fortësia e sipërfaqes 55÷62HRC

5. AMBALLAZHIMI:

Të jetë të paketuara në kuti kartoni jo më shumë se 50 copë / kuti.

Nëpër kuti sferat të jenë të lyera me vaj për mbrojtje nga oksigjeni dhe të mbështjella me plasmas.

Kutitë të jenë të pajisura me etiketa që shprehin dimensione, markën dhe sasitnë

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Sfera Inoksi”

1. EMËRTIMI:

- Sfera dërgimi pompa thellësie Ø 2”

2. DIMENSIONI : Diametri 11 / 14” (Ø 25.4mm)

3. MARKA : Çelik 9 Cr 18

4. KARAKTERISTIKAT TEKNIKE :

- Pastërtia e sipërfaqes së lapuar 0.8 (ashpërsia)
- Fusha e tolerancës së prodhimit ±0.18mm
- Marka e materialit 9 Cr 18
- Në sipërfaqe të mos ketë vijëzime të cilat dallohen me lupë 1x10
- Fortësia e sipërfaqes 55÷62HRC

5. AMBALLAZHIMI:

Të jetë të paketuara në kuti kartoni jo më shumë se 50 copë / kuti.

Nëpër kuti sferat të jenë të lyera me vaj për mbrojtje nga oksigjeni dhe të mbështjella me plasmas.

Kutitë të jenë të pajisura me etiketa që shprehin dimensione, markën dhe sasinë

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Sfera Inoksi”

6. EMËRTIMI:

- Sfera dërgimi pompa thellësie Ø 2”

7. DIMENSIONI : Diametri 11 / 14” (Ø 17.5mm)

8. MARKA : Çelik 9 Cr 18

9. KARAKTERISTIKAT TEKNIKE :

- | | |
|---|-----------------|
| • Pastërtia e sipërfaqes së lapuar | 0.8 (ashpërsia) |
| • Fusha e tolerancës së prodhimit | ±0.18mm |
| • Marka e materialit | 9 Cr 18 |
| • Në sipërfaqe të mos ketë vijëzime të cilat dallohen me lupë | 1x10 |
| • Fortësia e sipërfaqes | 55÷62HRC |

10. AMBALLAZHIMI:

Të jetë të paketuara në kuti kartoni jo më shumë se 50 copë / kuti.

Nëpër kuti sferat të jenë të lyera me vaj për mbrojtje nga oksigjeni dhe të mbështjella me plasmas.

Kutitë të jenë të pajisura me etiketa që shprehin dimensione, markën dhe sasinë

Për plotësimin e treguesve ekonomik-financiar të Programit të Zhvillimit të miratuar për vitin 2026, të detajuar sipas tremujorëve, si dhe emergjencave të qendrës, është e domosdoshme të sigurohen materialet:

- Gurë abrazivë, me përbërje dhe dimensione të ndryshme
Përdoren :
 - për mprehjen e instrumentave prerës të makinerive metalprerëse,
 - për retifikimin e detaleve të pompave të thellësisë, pompave të transportit të naftës dhe reduktorëve,
- Gure trokoje
Përdoren :
 - si instrument prerës në pajisjen e trokosë për të realizuar prerje të profileve, prokateve dhe detaleve të ndryshme.

Baza materiale si më sipër do të përdoret menjëherë në proceset e punës e të prodhimit në qendrën tonë.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Gurë abrazivë”

7. EMËRTIMI : Gurë abrazivë .

8. TIPI GURRIT : SHD (i sheshtë me profil drejtkëndor)

9. PËRMASAT :

- $\Phi 250 \times \Phi 25 \times 32 \text{mm}$
- $\Phi 350 \times \Phi 127 \times 40 \text{mm}$

10. KËRKESAT TEKNIKE :

- EB 46÷60; MB1Q
- Elektrokorundi i bardhë EB: oksidi aluminit $\text{Al}_2\text{O}_3 \geq 89\%$.
- Përmbajtja e kokrrizave : 46 ÷ 60% e volumit
- Fortësia e gurrit : MB1 (mesatar i butë i shkallës së parë)
- Lidhësi i elektrokorundit : Q(qeramik)
- Lagështia : $\leq 10\%$
- Shpejtësia periferike : $\div 30 \text{ m/sek}$

11. PËRDORIMI :

Për retifikimin e detaleve prej çeliku me përçindje të ulët karboni dhe fortësi të trajtimit termik $\geq 55 \text{ HRC}$.

12. AMBALLAZHIMI :

- Gurrët të jenë të pagoditur dhe të mos kenë plasaritje në trup.
- Të jenë të shoqëruar me etiketë në të cilën të shprehen karakteristikat e gurit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Gurë abrazivë”

- EMËRTIMI : Gurë abrazivë .
- TIPI GURIT : SHD (i sheshtë me profil drejtkëndëor)
- PËRMASAT :
- $\Phi 250 \times \Phi 25 \times 32 \text{mm}$
- $\Phi 350 \times \Phi 127 \times 40 \text{mm}$

KËRKESAT TEKNIKE :

- KJ 80÷120 MF1Q
- Karbit silic jeshil KJ : $\text{SiC} \geq 99\%$.
- Përmbajtja e kokrrizave : 80 ÷ 120% e volumit
- Fortësia e gurrit : MF1 (mesatar i fortë, i shkallës së parë)
- Lidhësi i elektrokorundit : Q(qeramik)
- Lagështia : $\leq 10\%$
- Shpejtësia periferike : $\geq 50 \text{ m/sek}$

PËRDORIMI :

Për retifikimin dhe zmerilimin e detaleve me material çelik i lidhur shpejtprerës (vidio tornimi) fortësia e të cilave është $\geq 60 \text{ HRC}$.

AMBALLAZHIMI :

- Gurët të jenë të pagoditur dhe të mos kenë plasaritje në trup.
- Të jenë të shoqëruar me etiketë në të cilën të shprehen karakteristikat e gurit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Gurë abrazivë”

1. EMËRTIMI : Gurë abrazivë
2. TIPI GURIT : SHDD1 (i sheshtë me profil drejtkëndor)
3. PËRMASAT : $\Phi 250 \times \Phi 75 \times 25 \text{mm}$
4. KËRKESAT TEKNIKE :
 - EN 60÷80 MF1Q
 - Elektrokorundi normal : oksidi aluminit $\text{Al}_2\text{O}_3 \geq 89\%$.
 - Përmbajtja e kokrrizave : 60 ÷80% e volumit
 - Fortësia e gurit : MF1 (mesatar i fortë i shkallës së parë)
 - Lidhësi i elektrokorundit : Q(qeramik)
 - Lagështia : $\leq 10\%$
 - Shpejtësia periferike : $\div 30 \text{ m/sek}$
5. PËRDORIMI :
Për retifikimin e jashtëm të detaleve me % të ulët karboni dhe fortësi sipërfaqësore nga trajtimi termik $\div 55\text{HRC}$.
6. AMBALLAZHIMI :
 - Gurët të jenë të pagoditur dhe të mos kenë plasaritje në trup.
 - Të jenë të shoqëruar me etiketë në të cilën të shprehen karakteristikat e gurrit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE**“Gurë abrazivë”**

7. EMËRTIMI : Gurrë abrazivë
8. TIPI GURIT : SHDD1 (i sheshtë me profil drejtkëndor)
9. PËRMASAT :
 - $\Phi 150 \times \Phi 50 \times 50 \text{mm}$
10. KËRKESAT TEKNIKE :
 - EN 60÷80 MF1Q
 - Elektrokorundi normal : oksidi aluminit $\text{Al}_2\text{O}_3 \geq 89\%$.
 - Përmbajtja e kokrrizave : 60 ÷80% e volumit
 - Fortësia e gurrit : MF1 (mesatar i fortë i shkallës së parë)
 - Lidhësi i elektrokorundit : Q(qeramik)
 - Lagështia : $\leq 10\%$
 - Shpejtësia periferike : $\div 30 \text{ m/sek}$
11. PËRDORIMI :
Për retifikimin e jashtëm të detaleve me % të ulët karboni dhe fortësi sipërfaqësore nga trajtimi termik $\div 55\text{HRC}$.
12. AMBALLAZHIMI :
 - Gurët të jenë të pagoditur dhe të mos kenë plasaritje në trup.
 - Të jenë të shoqëruar me etiketë në të cilën të shprehen karakteristikat e gurrit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Gurë abrazivë”

1. EMËRTIMI : Gurë abrazivë
2. TIPI GURRIT : SHD (i sheshtë me profil drejtkëndor)
3. PËRMASAT : $\Phi 400 \times \Phi 205 \times 40 \text{mm}$
4. KËRKESAT TEKNIKE :
 - EN 60÷80 MF1Q
 - Elektrokorundi normal : oksidi aluminit $\text{Al}_2\text{O}_3 \geq 89\%$.
 - Përmbajtja e kokrrizave : 60 ÷80% e volumit
 - Fortësia e gurrit : MF1 (mesatar i fortë i shkallës së parë)
 - Lidhësi i elektrokorundit : Q(qeramik)
 - Lagështia : $\leq 10\%$
 - Shpejtësia periferike : $\div 36 \text{ m/sek}$
5. PËRDORIMI :

Për retifikimin e jashtëm të detaleve me % të ulët karboni dhe fortësi sipërfaqësore nga trajtimi termik $\div 55 \text{ HRC}$.
6. AMBALLAZHIMI :
 - Gurët të jenë të pagoditur dhe të mos kenë plasaritje në trup.
 - Të jenë të shoqëruar me etiketë në të cilën të shprehen karakteristikat e gurrit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Gurë abrazivë”

1. EMËRTIMI : Gurë abrazivë
2. TIPI GURIT : SHDD1 (i sheshtë me profil drejtkëndor)
3. PËRMASAT : $\Phi 500 \times \Phi 225 \times 40 \text{mm}$
4. KËRKESAT TEKNIKE :
 - EN 60÷80 MF1Q
 - Elektrokorundi normal : oksidi aluminit $\text{Al}_2\text{O}_3 \geq 89\%$.
 - Përmbajtja e kokrrizave : 60 ÷80% e volumit
 - Fortësia e gurit : MF1 (mesatar i fortë i shkallës së parë)
 - Lidhësi i elektrokorundit : Q(qeramik)
 - Lagështia : $\leq 10\%$
 - Shpejtësia periferike : $\div 36 \text{ m/sek}$
5. PËRDORIMI :

Për retifikimin e jashtëm të detaleve me % të ulët karboni dhe fortësi sipërfaqësore nga trajtimi termik $\div 55 \text{ HRC}$.
6. AMBALLAZHIMI :

- Gurët të jenë të pagoditur dhe të mos kenë plasaritje në trup.
- Të jenë të shoqëruar me etiketë në të cilën të shprehen karakteristikat e gurrit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Gurë abrazivë”

1. EMËRTIMI : Gurë abrazivë
2. TIPI GURIT : SHDD1 (i sheshtë me profil drejtkëndor)
3. PËRMASAT : $\Phi 100 \times \Phi 32 \times 50$ mm
4. KËRKESAT TEKNIKE :
 - EN 60÷80 MF1Q
 - Elektrokorundi normal : oksidi aluminit $Al_2O_3 \geq 89\%$.
 - Përmbajtja e kokrrizave : 60 ÷ 80% e volumit
 - Fortësia e gurrit : MF1 (mesatar i fortë i shkallës së parë)
 - Lidhësi i elektrokorundit : Q(qeramik)
 - Lagështia : $\leq 10\%$
 - Shpejtësia periferike : $\div 30$ m/sek
 -
5. PËRDORIMI :
Për retifikimin e jashtëm të detaleve me % të ulët karboni dhe fortësi sipërfaqësore nga trajtimi termik ÷ 55 HRC.
6. AMBALLAZHIMI :
 - a. Gurrët të jenë të pagoditur dhe të mos kenë plasaritje në trup.
 - b. Të jenë të shoqëruar me etiketë në të cilën të shprehen karakteristikat e gurrit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Gurë abrazivë”

2. EMËRTIMI : Gurë abrazivë
3. TIPI GURIT : SHDD1 (i sheshtë me profil drejtkëndor)
4. PËRMASAT : $\Phi 120 \times \Phi 32 \times 50$ mm
5. KËRKESAT TEKNIKE :
 - EN 60÷80 MF1Q
 - Elektrokorundi normal : oksidi aluminit $Al_2O_3 \geq 89\%$.
 - Përmbajtja e kokrrizave : 60 ÷ 80% e volumit
 - Fortësia e gurit : MF1 (mesatar i fortë i shkallës së parë)
 - Lidhësi i elektrokorundit : Q(qeramik)
 - Lagështia : $\leq 10\%$
 - Shpejtësia periferike : $\div 30$ m/sek
6. PËRDORIMI :

Për retifikimin e jashtëm të detaleve me % të ulët karboni dhe fortësi sipërfaqësore nga trajtimi termik ÷ 55 HRC.

7. AMBALLAZHIMI :

- a. Gurët të jenë të pagoditur dhe të mos kenë plasaritje në trup.
- b. Të jenë të shoqëruar me etiketë në të cilën të shprehen karakteristikat e gurit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Gurë trokoje”

1. EMËRTIMI : Gurë trokoje.

2. TIPI GURIT : D (disk, gure trokoje)

3. PËRMASAT : Ø230mmx22x5 mm

4. KËRKESAT TEKNIKE : B 46÷60MF₁V

- Elektrokorundi bakelit B : oksidi aluminit Al₂O₃ ≥ 92%
- Përmbajtja e kokrrizave : ≥ 60 ÷80% e volumit
- Fortësia e gurit : MF₁ (mesatar i fortë i shkallës së parë)
- Lidhësi i elektrokorundit : V (vullkanik)
- Lagështia : ≤ 10%
- Shpejtësia periferike : ÷30 m/sek

5. PËRDORIMI :

Përdoret si instrument prerës në pajisjen e trokosë .

6. AMBALLAZHIMI :

- Të jenë të shoqëruar me etiketë të cilat të shprehin karakteristikat e gurit.
- Gurët të jenë të pagoditur dhe të mos kenë plasaritje në trup.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Gurë trokoje”

7. EMËRTIMI : Gurë trokoje.

8. TIPI GURIT : D (disk, gure trokoje)

9. PËRMASAT : Ø115mmx22x1 mm

10. KËRKESAT TEKNIKE : B 46÷60MF₁V

- Elektrokorundi bakelit B : oksidi aluminit Al₂O₃ ≥ 92%
- Përmbajtja e kokrrizave : ≥ 60 ÷80% e volumit
- Fortësia e gurit : MF₁ (mesatar i fortë i shkallës së parë)
- Lidhësi i elektrokorundit : V (vullkanik)
- Lagështia : ≤ 10%
- Shpejtësia periferike : ÷30 m/sek

11. PËRDORIMI :

Përdoret si instrument prerës në pajisjen e trokosë .

12. AMBALLAZHIMI :

- Të jenë të shoqëruar me etiketë të cilat të shprehin karakteristikat e gurit.
- Gurët të jenë të pagoditur dhe të mos kenë plasaritje në trup.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Gurë trokoje”

13. EMËRTIMI : Gurë trokoje.

14. TIPI GURIT : D (disk, gure trokoje)

15. PËRMASAT : Ø230mmx22x5 mm

16. KËRKESAT TEKNIKE : B 46÷60MF₁V

- Elektrokorundi bakelit B : oksidi aluminit $Al_2O_3 \geq 92\%$
- Përmbajtja e kokrrizave : $\geq 60 \div 80\%$ e volumit
- Fortësia e gurit : MF₁ (mesatar i fortë i shkallës së parë)
- Lidhësi i elektrokorundit : V (vullkanik)
- Lagështia : $\leq 10\%$
- Shpejtësia periferike : $\div 30$ m/sek

17. PËRDORIMI :

Përdoret si instrument prerës në pajisjen e trokosë .

18. AMBALLAZHIMI :

- Të jenë të shoqëruar me etiketë të cilat të shprehin karakteristikat e gurit.
- Gurët të jenë të pagoditur dhe të mos kenë plasaritje në trup.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Gurë trokoje”

1. EMËRTIMI : Gurë trokoje.

2. TIPI GURIT : D (disk, gure trokoje)

3. PËRMASAT : Φ_j 230mm x Ø_b22x1.8÷2mm

4. KËRKESAT TEKNIKE : B 46÷60MF₁V

- Elektrokorundi bakelit B : oksidi aluminit $Al_2O_3 \geq 92\%$
- Përmbajtja e kokrrizave : $\geq 60 \div 80\%$ e volumit
- Fortësia e gurit : MF₁ (mesatar i fortë i shkallës së parë)
- Lidhësi i elektrokorundit : V (vullkanik)
- Lagështia : $\leq 10\%$
- Shpejtësia periferike : $\div 30$ m/sek

5. PËRDORIMI :

Përdoret si instrument prerës në pajisjen e trokosë .

6. AMBALLAZHIMI :

- Të jenë të shoqëruar me etiketë të cilat të shprehin karakteristikat e gurit.
- Gurët të jenë të pagoditur dhe të mos kenë plasaritje në trup.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Lëndë e parë për Fonderinë

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Gize verxhino	kg	1200
2	Bronx bllok (lingotë) BrPbSnZn 5-5-5	kg	700
3	Qymyr koks	kg	1650
4	Dru zjarri	m ³	5
5	Kallaj	kg	115
6	Vaj limi	litra	61

Materiale specifike:

Nr.	Emërtimi i Materialit	Njësia	Sasia
1	Vaj naftalik	litra	200
2	Vajguri	litra	100
3	Shufra bronxi për saldim me gaz & oksigjen	kg	5
4	Shufra bronxi për saldim me gaz & oksigjen	kg	2
5	Shirrita sharre bimetalik per prerje çeliku	cope	28
6	Llampa ndriçimi per torno	cope	8
7	Mandrino vetcentruese Φ 315mm	cope	1
8	Anhidrit kromi	kg	100
9	Maja diamanti industrial	cope	4
10	Acid sulfurik	litra	10

Brumë gome antivaj:

Nr.	Emërtimi i Materialit	Njësia	Sasia
1	Brum gome antivaj	kg	350
2	Kauçuk sintetik	kg	10

Sfera inoksi:

Nr.	Emërtimi i Materialit	Njësia	Sasia
1	Sfera inoksi Ø 38.2	copë	54
2	Sfera inoksi Ø 31.75	copë	160
3	Sfera inoksi Ø 25.4	copë	80
4	Sfera inoksi Ø 17.5	copë	26

Gurë abrazivë:

Nr	Emërtimi i artikullit	Specifikimet teknike	Njësia	Sasia
1	Gurë abrazive SHD Ø250xØ25x32	EB 46÷60 ; MB1Q	copë	3
2	Gurë abrazivë SHD Ø350xØ127x40	EB 46÷60 ; MB1Q	copë	3
3	Gurë abrazivë SHD Ø250xØ25x32	KJ 80÷120; MF1Q	copë	20
4	Gurë abrazivë SHD Ø350xØ127x40	KJ 80÷120; MF1Q	copë	3
5	Gurë abrazivë SHD Ø400xØ205x40	EN 60÷80; MF1Q	copë	3
6	Gurë abrazivë SHD Ø500xØ225x40	EN 60÷80; MF1Q	copë	2
7	Gurë abrazivë SHDD1 Ø250xØ75x25	EN 60÷80; MF1Q	copë	2
8	Gurë abrazivë SHDD1 Ø100xØ32x50	EN 60÷80; MF1Q	copë	3
9	Gurë abrazivë SHDD1 Ø120xØ32x50	EN 60÷80; MF1Q	copë	3
10	Gurë abrazive SHDD1 Ø150xØ50x50	EN 60÷80; MF1Q	copë	3
11	Gurë trokoje	Ø 230 mm x 22 x 5 mm	copë	4
12	Gurë trokoje	Ø230mm x 22 x 1.8 – 2 mm	copë	80
13	Gurë trokoje	Ø 115 mm x 22 x 1 mm	copë	10

Afatet e lëvrim:

Sasia e mallit objekt prokurimi do të levrohet jo më vonë se **60 dite** nga lidhja e kontrates. Kontraktuesi duhet të dorëzojë mallin objekt prokurimi sipas sasisë perkatese, pranë magazinave së QMN Kuçovë ku do të merret në dorëzim nga Komisioni i Marrjes në Dorëzim të Mallit i ngritur me urdher të posacem.

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % se vlera e fondit limit.

2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si deshmi për pervojen e mëparshme kerkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

OSE

Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si deshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

- 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për artikujt:

Bronx bllok (lingotë) BrPbSnZn 5-5-5

Vaj naftalik

Shiriti sharre bimetalik për prerje çeliku

Brum gome antivaj

Gurë abrazivë SHD Ø250xØ25x32 me specifikime KJ 80÷120; MF1Q

Ne rast se do të paraqitet autorizim nga distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Në autorizim duhet të jenë të paraqitura të dhëna të sakta të Prodhuarit/Distributorit (adresë, web-site, e-mail, telefon) në mënyrë që AK të ketë mundësi të kryej verifikimet nëse do të nevojitet.

- 2.3.3. Katalog teknik/skede teknike, nga firma prodhuese për artikujt:

Bronx bllok (lingotë) BrPbSnZn 5-5-5

Vaj naftalik
Shirrit sharre bimetalik per prerje çeliku
Brum gome antivaj
Gurë abrazivë SHD Ø250xØ25x32 me specifikime KJ 80÷120; MF1Q

Katalogu/skeda teknike te permbaje karakteristikat teknike te artikujve qe jane objekt i prokurimit me qellim qe Autoriteti Kontraktor te gjykoje nese malli i ofruar ploteson kerkesat teknike te percaktuara ne dokumentat e tenderit. Ne katalogun/skeden e paraqitur te shenohen ne menyre te dukshme të gjitha specifikimet teknike të mallit të ofruar. (Pjeset specifike te katalogut ku jepen karakteristikat e mallit qe prokurohet nqs nuk jane ne gjuhen shqipe te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen).

2.3.4. Operatori ekonomik duhet te paraqesë perpara afatit të fundit për hapjen e ofertave nga një mostër përfaqësuese për artikujt:

Bronx bllok (lingotë) BrPbSnZn 5-5-5
Vaj naftalik
Shirrit sharre bimetalik per prerje çeliku
Brum gome antivaj
Gurë abrazivë SHD Ø250xØ25x32 me specifikime KJ 80÷120; MF1Q

Mostrat te paraqiten dhe te dorezohen ne zyren e protokoll arkives te Albpetrol sha Patos me seli ne rrugen Fier-Patos km 7, se bashku me nje dokument per paraqitje mostre te protokolluar ne Albpetrol sha, perpara afatit te fundit per paraqitjen e ofertave, ne menyre qe te jene ne dispozicion te Komisionit te Vleresimit te Ofertave.

*Mostrat do te jene kofidenciale per sejcilin Operator Ekonomik dhe do ti kthehen Operatorit ekonomik brenda 30 diteve nga data e lidhjes se kontrates me paraqitjen e nje kerkese prane AK nga ana e OE ofertues.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikaten ISO 9001:2015 ose e përditësuar mbi "Sistemin e menaxhimit të cilësisë", ose ekuivalente (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

